

Stilizimi i HTML-së me CSS

CSS është shkurtesë nga **Cascading Style Sheets**.

CSS përshkruan **se si elementet HTML-së paraqiten në ekran, letër apo në medie tjera**.

CSS-i **kursen shumë kohë gjatë punës**. Ai mund të kontrolloj pamjen e disa web-faqeve përnjëherë.

CSS-i mund t'i shtohet elementeve HTML në 3 mënyra:

- **Inline** (në linjë) – duke përdor atributet e stileve në elementet e HTML-së,
- **Internal** (i brendshëm) – duke përdor elementin `<style>` në seksionin `<head>` dhe
- **External** (i jashtëm) – duke përdor një skedar të jashtëm CSS

Mënyra më e zakonshme për ta përdorur CSS është vendosja e stilit nga jashtë, si skedar CSS të ndarë. Megjithatë, këtu do t'i përdorim metodeën e parë dhe dytë, pasi këto dy metoda janë më të lehta për t'i demonstruar, dhe më lehtë për ju që vet t'i provoni.

Inline CSS

Inline CSS përdoret për të vendosur në stil unik në një element të vetëm HTML.

Inline CSS përdor atributin e stilit në një element HTML.

Ky shembull ngjyros me ngjyrë të kaltër tekstin e elementit `<h1>`:

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<body>

<h1 style="color:blue;">Ky është titull i kaltër</h1>

</body>
</html>
```

Ky është titull i kaltër

Internal CSS

Internal CSS përdoret për të definuar stilin brenda një faqeje HTML.

Internal CSS definohet në seksionin <head> të faqes HTML, brenda elementit <style>:

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<style>
  body {background-color: yellow;}
  h1   {color: blue;}
  p    {color: red;}
</style>
</head>
<body>

  <h1>Ky është titull</h1>
  <p>Ky është paragraf.</p>

</body>
</html>
```

Ky është titull

Ky është paragraf.

External CSS

Stili i jashtëm përdoret për të definuar pamjen për disa faqe HTML.

Me external CSS, mund të ndryshoni pamjen e plotë të një web-sajti duke bërë ndryshime vetëm në një skedar!

Për të përdorur CSS e jashtëm, shtoni linkun në seksionin <head> të faqes HTML:

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
  <link rel="stylesheet" href="stili.css">
</head>
<body>

<h1>Ky është titull</h1>
<p>Ky është paragraf.</p>

</body>
</html>
```

Ky është titull

Ky është paragraf.

Një CSS i jashtëm mund të krijohet në çfardo tekst-editor. Skedari i krijuar nuk duhet të ketë asnjë kod HTML, dhe duhet të ruhet me ekstensionin **.css**.

Kësisoj duket skedari "stili.css":

```
body {
    background-color: yellow;
}
h1 {
    color: blue;
}
p {
    color: red;
}
```

Fontet në CSS

Atributi i CSS-it **color** definon ngjyrën e tekstit që do të përdoret.

Atributi i CSS-it **font-family** definon fontin që do të përdoret.

Atributi i CSS-it **font-size** definon madhësinë e tekstit që do të përdoret.

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<style>
h1 {
    color: blue;
    font-family: verdana;
    font-size: 300%;
}
p {
    color: red;
    font-family: courier;
    font-size: 160%;
}
</style>
</head>
<body>

<h1>Ky është titull</h1>
<p>Ky është paragraf.</p>

</body>
</html>
```

Ky është titull

Ky është paragraf.

Kufiri në CSS

Atributi CSS **border** definon kufirin (skajin) përreth elementit HTML:

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<style>
p {
  border: 1px solid powderblue;
}
</style>
</head>
<body>

<h1>Ky është titull</h1>

<p>Ky është paragraf.</p>
<p>Ky është paragraf.</p>
<p>Ky është paragraf.</p>

</body>
</html>
```

Ky është titull

Ky është paragraf.

Ky është paragraf.

Ky është paragraf.

Mbushja në CSS

Atributi i CSS-it **padding** definon mbushjen (hapësirën) në mes tekstit dhe kufirit:

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<style>
p {
  border: 1px solid powderblue;
  padding: 30px;
}
</style>
</head>
<body>

<h1>Ky është titull</h1>

<p>Ky është paragraf.</p>
<p>Ky është paragraf.</p>
<p>Ky është paragraf.</p>

</body>
</html>
```

Ky është titull

Ky është paragraf.

Ky është paragraf.

Ky është paragraf.

Margjina në CSS

Atributi CSS **margin** definon margjinën (hapësirën) jashta kufirit:

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<style>
p {
  border: 1px solid powderblue;
  margin: 30px;
}
</style>
</head>
<body>

<h1>Ky është titull</h1>

<p>Ky është paragraf.</p>
<p>Ky është paragraf.</p>
<p>Ky është paragraf.</p>

</body>
</html>
```

Ky është titull

Ky është paragraf.

Ky është paragraf.

Ky është paragraf.

Atributi ID

Për të definuar një stil specifik për një element të veçantë duhet shtuar një atribut ID në element:

```
<p id="p01">Unë jam ndryshe</p>
```

e më pas definojmë stilin për elementin me ID specifike.

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<style>
#p01 {
    color: blue;
}
</style>
</head>
<body>

<p>Ky është paragrafi.</p>
<p>Ky është paragrafi.</p>
<p id="p01">Unë jam ndryshe.</p>

</body>
</html>
```


Ky është paragrafi.

Ky është paragrafi.

Unë jam ndryshe.

Njoftim: ID-ja e një elementi duhet të jetë unike brenda një faqeje, andaj selektori ID përdoret për të zgjedh një element unik.

Atributi CLASS

Për të definuar stilin për tipin special të elementeve, shtoni një atribut CLASS në atë element:

Shembull:

```
<!DOCTYPE html>
<html>
<head>
<style>
p.gabim {
  color: red;
}
</style>
</head>
<body>

<p>Ky është paragrafi.</p>
<p>Ky është paragrafi.</p>
<p class="gabim">Unë jam ndryshe.<p>
<p>Ky është paragrafi.</p>
<p class="gabim">Unë jam ndryshe, gjithashtu.<p>

</body>
</html>
```

Ky është paragrafi.

Ky është paragrafi.

Unë jam ndryshe.

Ky është paragrafi.

Unë jam ndryshe, gjithashtu.